

METODOLOGJI

PËR VLERËSIMIN, ANALIZIMIN DHE PRIORITIZIMIN E PROBLEMATIKAVE NË MJEDIS DHE NË BURIMET NATYRORE LOKALE

Përgatiti: Nihat Dragoti, ekspert i legjislacionit mjedisor

Tiranë, më 02.02.2022

Publikuar nga:

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA)

Rr. Islam Alla, Pall. IVEA, kati i 1, Tirana

Tel/fax: +355 42231437

<http://www.inca-al.org>

E-mail: info@inca-al.org

Metodologjia është përgatitur në kuadër të projektit “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”, me mbështetjen financiare të LëvizAlbania, një projekt i Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC).

Përmbajtja e metodologjisë është përgjegjësi e INCA dhe autorëve, si dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Contents

SHKURTIME	4
1.HYRJE	5
2.METODOLOGJIA	8
3.ANKETIMI-INTERVISTIMI.....	14
3.1 PËRGJIGJA E PYETJES.....	15
4.PËRGJITHËSIME MBI PROBLEMATIKAT NË MJEDIS DHE NË BURIMET NATYRORE – ANALIZA NË KUADËR TË GRUPEVE TË INTERESIT NË ZONAT PILOTE	17
4.1 Ç'farë mund të veçojmë nga problematika dhe ndikimet për analizën në zonat pilote?.....	20
5.ANALIZA E TË DHËNAVE TË PYETËSORIT DHE PËRGATITJA E RAPORTIT.....	26
6. REKOMANDIME	27
ANEKSET	28
1.Tabela: Lista përmbledhëse e problematikave mjedisore dhe të burimeve natyrore, në bashkie ..	28
2. Pyetësorit dhe Grafikët e plotësuar, në nivel bashkie.	28
TË DHËNAT E PYETËSORIT	29
1. Grupmoshat e përfshira në anketim.....	29
2.Sa e rëndësishme është ruajtja e mjedisit natyror në bashkinë tuaj?	29
3.A ka plan veprimi për mjedisin të miratuar në bashkinë tuaj?	29
4.A mendoni se problemet mjedisore janë prioritare në politikën vendore?	30
5.A organizohen takime të rregullta nga administrata e bashkisë për e ruajtjen dhe administrimin e burimeve natyrore?	30
6.Cili është mendimi juaj për punën e strukturave të bashkisë në lidhje me ruajtjen dhe përdorimin e burimeve natyrore?	30
7.Si e vlerësoni nivelin e përfshirjes Suaj në punët dhe problemet mjedisore të bashkisë?	30
8.A jeni përfshirë në ndonjë aktivitet në problematika mjedisore?.....	30
9.Si OJF, a Ju kërkojnë mendimin tuaj mbi çështjet në lidhje me aktivitetet mjedisore që zhvillon bashkia?	31
10.Cili është mendimi juaj për zbatimin e ligjshmërisë në lidhje me ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore?	31
11.A ka raste të dukurive të korrupsionit dhe krimit mjedisor në administrimin dhe përdorimin e burimeve natyrore në bashkinë tuaj?	31
12. Përshkruani nismat e Oganizatës dhe të rrjetit tuaj për parandalimin, luftimin dhe adresimin e rasteve të korrupsionit në përdorimin e burimeve natyrore.	31
13.Nga pikëpamja Juaj, cilat janë vlerat më të rëndësishme mjedisore e natyrore në bashkinë tuaj?	32

<i>14. Cilat janë përfitimet më të rëndësishme social-ekonomike dhe ekoturistike që territori i bashkisë ofron për komunitetin lokal.</i>	<i>32</i>
<i>15. Identifikoni se cilët janë problemet me ndikim negativ, që dëmtojnë mjedisin, natyrën, biodiversitetin dhe peizazhin në bashkinë tuaj?</i>	<i>32</i>
<i>16. Nga problematikat e identifikuara me ndikim negativ, shënoni veprimtaritë, sipas riskut potencial (nivelit të dëmtimit) të tyre.</i>	<i>32</i>
<i>17. Cilët janë shkaqet kryesore të ndikimeve negative të mjedisit në bashkinë tuaj?</i>	<i>33</i>
<i>18. Cilët janë shkaktarët e dëmtimit dhe ndotjes së mjedisit në bashkinë tuaj?</i>	<i>33</i>
<i>19. Përcaktoni 2 prioritete më të domosdoshme të problematikave në mjedis dhe burimet natyrore të cilat duhen bërë prezent në strukturat e bashkisë apo/dhe në autoritetet e tjera shtetërore në nivel lokal.</i>	<i>33</i>
<i>20. A ka zona të mbrojtura, që përfshihen në territorin e bashkisë?</i>	<i>33</i>
<i>21. A zhvillohen aktivitete ndërgjegjësuese dhe edukuese në zonën tuaj për promovimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore?</i>	<i>34</i>
<i>22. A janë trajtuar në mediet lokale problematikat e menaxhimit të mjedisit dhe të burimeve natyrore?</i>	<i>34</i>

SHKURTIME

AdZM	Administratë e Zonave të Mbrojtura
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
BE	Bashkimi Evropian
INCA	Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri
KB	Këshilli Bashkiak
KM	Këshilli i Ministrave
KoP	Kodi Penal
MBZhR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Nj.Ad	Njësia Administrative
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
OMShC	Organizatë Mjedisore e Shoqërisë Civile
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PDV	Plani i Detyruar Vendor
PIMZM	Plani i Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur
PMBN	Plani i Menaxhimit të Burimeve Natyrore
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
PVM	Plani i Veprimit në Mjedis
SDC	Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZMM	Zonë e Mbrojtur Mjedisore

1.HYRJE

Metodologjia është përgatitur në kuadër të projektit “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”, me mbështetjen financiare të LëvizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë për ndërtimin e një qytetarie (lëvizje komunitare) aktive, partnere e njohur në procesin e qeverisjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm në nivel lokal dhe kombëtar. Për këtë synohet:

1. Të nxisë rrjetëzime kombëtare dhe lokale aktive të OShC-ve për ruajtjen e natyrës dhe partneritetin e tyre në programe pune afatgjatë advokimi për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

2. Të rrisë angazhimin qytetar/komunitar dhe mediatik në aktivitetet advokuese të OShC-ve për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore lokale, duke përdorur të drejtën për informacion dhe pjesëmarrje mbi procesin e zbatimit të politikave dhe vendimmarrjes që ndikon në burimet natyrore lokale.

Projekti ka për qëllim të risë dhe përmirësojë aftësitë e OShC-ve, potencialin dhe rolin aktiv të tyre në analizimin, monitorimin dhe advokimin për zbatimin e ligjit dhe politikave, me qëllim përmirësimin e menaxhimit dhe ruajtjes së burimeve natyrore edhe fuqizimit të rolit të OShC-ve në luftën kundër korrupsionit dhe minimizimit të ndikimeve negative në keq menaxhimin e burimeve natyrore dhe zonave të mbrojtura mjedisore (ZMM); të inkurajojë bashkëpunimin midis OShC-ve dhe autoriteteve publike, komuniteteve lokale, mediave; dhe të inkurajojë krijimin e rrjeteve ose partneritetit midis tyre.

Qëllimi është analiza e hollësishme e kornizave kombëtare rregullatore që qeverisin pjesëmarrjen e publikut, të drejtën për informim dhe luftimin e korrupsionit në përdorimin e burimeve natyrore dhe ZMM-ve si dhe procesin e menaxhimit të tyre. Përmes kësaj analize identifikohen dhe përshkruhen roli dhe rëndësia relative e palëve të përfshira dhe veçanërisht të OShC-ve dhe rrjetëzimeve të tyre lokale, në njohjen dhe kuptimin e kuadrit ligjor e rregullator të OShC-ve, dhe aktorëve lokalë në bashkitë: Has, Lezhë dhe Divjakë.

Të gjithë partnerët dhe rrjetit lokale duhet të zhvillojnë një marrëdhënie të ngushtë pune për të plotësuar dhe për të mos mbivendosur gjetjet dhe materialet e tyre në përputhje me qëllimin dhe objektivat kryesore të projektit. Ata duhet të bashkëpunojnë në mbajtjen e komunikimit të rregullt përmes kontakteve, për të cilat Instituti për Ruajtjen e Natyrës (INCA), si lider, do të organizojë dhe realizojë takime të kushtëzuara për mirëvajtjen e procesit me rrjetet lokale të OShC-ve partnere.

Kryerja e vlerësimit, do të realizohet me kontributin e 3 OShC-ve dhe të OJF-ve pjesë e rrjetit lokal të tyre. OJF-t lokale të përfshira në këtë proces, duhet të ndërmarrin një numër të gjerë takimesh konsultative, për grumbullimin, vlerësimin dhe analizimin e materialeve të ndryshme, në lidhje me problematikat lokale dhe prioritizimin e tyre, me fokus përdorimin e burimeve natyrore dhe informimi/pjesëmarrje publike në vendimmarrjen.

Vlerësimi do të realizohet duke u mbështetur tek modelet dhe në takimet informuese të organizuara, sipas kësaj metodologjie. Mbi këtë bazë organizatat partnere dhe rrjetet e tyre lokale do të ndërtojnë, më pas, programe vlerësimi/monitorimi (watch-dog) dhe prioritizimin e problematikave kryesore të identifikuar, si më të nevojshme, për t'u adresur; si dhe do të ndërtojnë edhe strategjinë e advokimit, të cilën do synojnë ta zbatojnë në vazhdimësi.

Gjithashtu, metodologjia do të mundësojë vlerësimin e nevojave dhe nxitjen e një bashkëpunimi sa më efektiv mes shoqërisë civile dhe strukturave në nivel lokal të qeverisjes vendore si dhe partneritetin mes tyre në nisma dhe aktivitete të përbashkëta që kanë për qëllim adresimin dhe minimizimin e problemeve negative mjedisore. Kësisoj edhe promovimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe vlerave të biodiversitetit.

Në këtë drejtim INCA punojë për hartimin dhe më pas zbatimin e një pyetëso-anketues të vlerësimit efektive, i cili do të marrë në konsideratë procesin e grumbullimit dhe analizimit të fakteve të mbledhura si dhe tërheqjen e vëmendjes publike drejt problematikave kryesore me të cilat përballen sot këto zona pilote.

Gjatë këtij procesi vlerësim/analizimi duhet punuar për ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi për identifikimin e problematikave kryesore mjedisore dhe për burimet natyrore me të cilat përballen zonat, në bashkitë e përzgjedhura.

Vlerësimi i situatës aktuale duhet të jetë rezultat i takimeve dhe i investigimeve në terren të organizuara me përfaqësues komuniteteve, kryepletë, administratorët e njësive administrative, të bizneseve, shkollat, OJF-ve mjedisore, administratat vendore, me përdorues e përfitues të burimeve natyrore, etj. Nëpërmjet këtyre takimeve duhet të sigurohet një pamje e përgjithshme të problemeve ekzistuese dhe potenciale në zonat pilote, të cilat kanë ndikim në biodiversitet, ekosisteme, peizazhe, burimet natyrore dhe në zhvillimin vendor social-ekonomik.

Me këtë vlerësim, më pas dhe analizimin e problemeve të shkaktuara, krahas adresimit do të synohet që të arrihet qëllimi për reagimin ndaj tyre si dhe caktimin e rekomandimeve përkatëse për minimizimin e ndikimeve negative. Aplikimi i procesit të vlerësimi për grumbullimin e informacionit faktik dhe real mbi të gjitha aktivitetet me ndikim negativ brenda territorit në 3 zonat pilote të përzgjedhura me siguri do të sjelli rezultate pozitive në bashkitë përkatesë.


Gjithashtu, procesi i identifikimit dhe analizimit të problemeve kryesore dhe të ndikimeve negative në menaxhimin e mjedisit natyror dhe të burimeve natyrore do të këshillohet edhe me Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV), Planin e Detyruar Vendor (PDV), Planin e Veprimtari në Mjedis (PVM) të bashkisë si dhe me planet apo projektet për administrimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore (PMBN) dhe zonat e mbrojtura mjedisore (PIMZM).

Njëherazi duhet të shqyrtohen dhe strategjitë, planet, programet dhe raportet e hartuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), kryesisht të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe Agjencisë Kombëtare të

Pyjeve (AKP). Po kështu edhe të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës (MIE), kryesisht të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZhR), etj.

Të dhënat që u grumbulluan, për vlerësimin e mangësive, duhet të fokusohen mbi një grup elementesh të mjedisit, biodiversitetit dhe burimet natyrore, të cilët shërbejnë edhe si indikatorë të analizës, por dhe objektiva për matjen e suksesit të ruajtjes dhe menaxhimit të tyre.

HARTA E VENDNDODHJES SË ZONAVE PILOTE



2.METODOLOGJIA

Metodologjia bazohet përgjithsisht tek Pyetëso-ri-Anketues-Individual. Qëllimi kryesor i anketimit është identifikimi dhe vlerësimi që lidhet me njohjen e problematikave aktuale që shqetësojnë dhe shoqërojnë ruajtjen, administrimin dhe menaxhimin e mjedisit, burimet natyrore dhe zonat e mbrojtura.

Në këtë proces identifikimi dhe vlerësimi i problematikave mjedisore dhe i burimeve natyrore të qeverisjes vendore duhet të jenë specifik, pasi kanë një qasje gjithëpërfshirëse, të vazhdueshme për zhvillimin e instrumenteve efektive të ruajtjes së mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore si dhe në luftën ndaj korrupsionit.

Gjithashtu, në zbatimin e metodologjisë duhet bërë kujdes për dallimin mes Monitorimit dhe Vlerësimit.

Monitorimi, është një proces i vazhdueshëm, që fillon me miratimin planit dhe aktiviteteve të mjedisit. Nëpërmjet monitorimit bëhet e mundur përputhja ndërmjet objektivave, politikave dhe projekteve që janë shprehur tek plani i veprimit në mjedis. Ky proces bën të mundur nxjerrjen e faktorëve pozitiv dhe negativ që ndikojnë gjatë zbatimit të këtij plani.

Vlerësimi, është një analizë e hollësishme e veprimtarive që zhvillohen në një mjedis apo/dhe tek burimet natyrore, ku informacioni i siguruar krahason ndikimet aktuale dhe të ardhshme si dhe mat në mënyrë sistematike eficientë dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve konkrete nëpërmjet rezultateve dhe treguesve përkatës.

Në rastin tonë, identifikimi dhe vlerësimi i faktorëve dëmtues dhe kërcënimet për mjedisin, ruajtjen dhe përdorimin e burimeve natyrore, duhet të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me grupet e interesit, me OJF-t e rrjetëzuara për secilën zone pilote të marrë në studim, dhe me strukturat përkatëse në bashki apo/dhe institucionet e tjera publike në nivel Njësie Administrative (Nj.Ad).

Vlerësimi i situatës aktuale duhet të jetë rezultat i takimeve dhe i investigimeve në terren, ku nëpërmjet këtyre takimeve të sigurohet një pamje e përgjithshme të problemeve ekzistuese dhe potenciale në mjedis, të cilat kanë ndikim në biodiversitet, ekosisteme, peizazhe, burimet natyrore dhe në zhvillimin vendor social-ekonomik.

Identifikimi i prioriteteve nënkupton ndërmarrjen e disa hapave të ndryshëm vlerësimi. Vlerësimi i presioneve dhe kërcënimeve ndaj zonave të përzgjedhura dhe në ekosistemet e pambrojtura, njëherazi shërben edhe për të identifikuar veprimet emergjente që duhen marrë për kërcënimet edhe ndaj sistemit të zonave të mbrojtura.

Për të patur një ecuri të unifikuar dhe sukses të këtij procesi organizata partnere, së bashku me OJF-t e rrjetit, duhet të kryejnë një analizë për të pasqyruar problematikën dhe mangësitë për ndikimet negative në nivel njësie administrative dhe bashkie, si dhe të nënvizojnë prioritetet që duhen adresuar dhe sugjerime për veprimet e nevojshme. Në këto takime së bashku me ekspertin duhet të parapërgatiten anëtarët e rrjeti të OJF dhe aktorët e tjerë për zbatimin e metodologjisë.

Ekzistojnë disa opsione të ndryshme për grumbullimin dhe përdorimin e të dhënave për të identifikuar problematikat mjedisore dhe të burimeve natyrore. Por, është zgjedhur metodologjia e pyetësorit/anketimit. Kjo metodologji jep drejtimet kryesore dhe rolin që kanë OShC-t për përmirësimin e menaxhimit dhe mënjanimin e impakteve negative në mjedis dhe burimet natyrore.

Burimet që do të përdoren për identifikimin dhe vlerësimin e problematikave duhet të jetë të pa kufizuar, të integruar dhe një kombinim ndërmjet:

(i) **Analizës ligjore-institucionale dhe shqyrtim të dokumentacionit**, si metodë cilësore e cila përfshin një analizë të të gjitha akteve ligjore në fuqi, vendime të Këshillit të Ministrave (VKM) në lidhje me administrimin dhe qeverisjen e burimeve natyrore; kuadrin ligjor që rregullon fushën e veprimit të institucioneve përgjegjëse në nivel lokal; të aktet administrative që përcaktojnë rregulla të përgjithshme, norma e standarde të detyrueshme në kushtet e qeverisjes vendore.

Këto burime duhet të përdoren në fazën paraprake të procesit të vlerësimit në mënyrë që të përftohet një panoramë e përgjithshme e qeverisjes së burimeve natyrore si dhe e identifikimit të shkaqeve më të ekspozuara ndaj riskut të ndikimeve negative në mjedis.

Për këtë ekspertit duhet të mbledhi dhe analizoj dokumentat, programet, planet zhvillimore, të menaxhimit dhe të veprimit në mjedis, projektet për burimet natyrore dhe zonat e mbrojtura, raportet, analizat dhe çdo informacion përkatës në lidhje me problematika mjedisore dhe të burimeve natyrore në nivel vendor.

(ii) **Pyetëtori dhe anketimet** konsistojnë në grumbullimin dhe interpretimin e gjetjeve që përfshin llojeshmërinë e intervistave me grupet e interesit në sektorë të ndryshëm, me punonjësit e administratës, kryepleqtë, mësues, të rinj, shoqata biznesi, individë, etj., Po kështu analizën statistikore si dhe çështje të veçanta apo për aktivitetet e ekspozuara ndaj korrupsionit. Njëherazi me identifikimin e risqeve kryhet edhe identifikimi i faktorëve të riskut (burimet, ndikimin, shkaktarët).

Këto burimet duhet të përdoren për një analizë më të detajuar mbi risqet më kritike, duke përfshirë edhe një analizë të specializuar në lidhje me nivelin e mundësisë së shfaqjes dhe të impakti në qeverisjen vendore. Për këtë ekspertit dhe grupi i punës do të drejtojnë dhe udhëzojnë të anketuarit për plotësimin korrekt dhe me vërtetësi të pyetësorit, për të identifikuar dhe vlerësuar problematika si dhe marrjen dhe dhënien e mendimeve të pakushtëzuar të të anketuareve mbi këto problematika.

Zbatimi i metodologjisë synon një proces korrekt për grumbullimin e informacionit faktik dhe real mbi të gjitha problematikat dhe aktivitet me ndikim negativ brenda territorit në zonat pilote të përzgjedhura, si mjet efektiv nëpërmjet takimeve dhe bashkëbisedimeve me komunitetin, palët e tjera të interesuara, biznesi, përdorues, individët dhe punonjës të administratës publike vendore si dhe të Administratës së Zonës të Mbrojtur (AdZM).

Metodologjia të përdoret si një gërshetim procesesh dhe disiplinash që synonë identifikimin e gjendjes me të cilat përballen sot këto zona pilote.

Metodologjia bazohet në harmonizimin e treguesve cilësor dhe sasiorë që do të grumbullohen në terren, mbi bazën e opinionëve të personave të anketuar. Gjithashtu, metodologjia mbështetet në “përjasjen pjesëmarrëse” me synim gjithëpërfshirjen e grupeve të interesit dhe në identifikimin e problematikës kryesore, veçanërisht të ndikimeve negative të ruajtjes dhe menaxhimit të mjedisit dhe të burimeve natyrore.

Identifikimi, vlerësimi dhe prioritizimi i problematikave dhe ndikimeve negative do të kryhet në zonat pilote si më poshtë:

1. Bashkia Divjakë dhe Njësitë Administrative (Divjakë, Grabian, Gradishtë, Remas dhe Tërbuf).
2. Bashkia Has dhe Njësitë Administrative (Fajzë, Gjinaj, Golaj dhe Krumë).
3. Bashkia Lezhë dhe Njësitë Administrative (Balldren, Blinisht, Dajç, Kallmet, Kolsh, Lezhë, Shëngjin, Ungrej dhe Zejmen).

Identifikimi i problematikave mjedisore dhe të burimeve natyrore, nëpërmjet anketimit dhe përfshirjes së gjerë të komuniteteve, administratorëve, përfituesve dhe përdoruesit e burimeve natyrore, ka synim vlerësimin dhe analizimin e tyre në nivelin e njësisë administrative dhe bashkie, sipas prioriteteve, nevojave dhe shpërndarjes në zonat pilote të marra në studim.

Metodologjia bazohet kryesisht në proceset e dialogut dhe konsultimit me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit, nëpërmjet bashkëbisedimeve dhe plotësimin e pyetësorit individual, për të identifikuar problematikën në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve natyrore.

Anketimi i siguron OJF-ve, institucioneve publike dhe private, të dhëna dhe elementë të rëndësishme për rekomandime në hartim politikash, ndërhyrjesh si dhe shërben si orientues në procesin e hartimit apo rishikimit të projekteve në funksion të nevojave aktuale praktike dhe zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Problematikat e identifikuara do të vlerësohen në lidhje me renditjen e risqeve duke filluar nga risqet më parësore që paraqesin impakt thelbësor në administrimin dhe përdorimin e burimeve natyrore dhe që mund të rrezikojnë efektshmërinë e masave që duhen ndërmarrë në mënyrë të vazhdueshme. Rëndësia e risqeve do bëhet sipas rëndësisë, ku ato prioritare kërkojnë trajtim të menjëhershëm me masa prioritare.

Problematikat e identifikuara, sipas prioritetit dhe të shoqëruara me masat përkatëse, do të jenë pjesë e Planit të Veprimit në Mjedis (PVM) apo/dhe të Menaxhimit të Burimeve Natyrore (PMBN) dhe të PIMZM. Qëllimi i planit është dokumentimi i mënyrës se si do të zbatohen masat e caktuara, që përfshijnë: përshkrimin e problematikave të identifikuara, objektivat e planit të veprimit, aktivitetet e propozuara, kostot financiare, personat përgjegjës, si dhe afatin e zbatimit etj. Njëherazi edhe për përgatitjen dhe zbatimin e strategjisë së OShC për advokim dhe lobim të problematikës së përzgjedhur në insitucionet përgjegjëse, në nivel vendor dhe qendror.

Përgjigjet e pyetësorëve do të përdoren vetëm për qëllimet e hartimit të raportit dhe të synimeve të projektit. Ato do të përdoren për të rekomanduar hapat e ardhshëm drejt përmirësimit të ruajtjes dhe menaxhimit të mjedisit, forcimit të kapaciteteve të stafit të

administratës publike në nivel lokal dhe të OShC-ve si dhe të forcimit të bashkëpunimit dhe të pjesëmarrjes së komuniteteve në procesin e administrimit dhe të përfitimeve.

Aktivitetet e parashikuara për t'u realizuara, sipas kësaj metodologjie, përfshijnë:

a. Krijimi i Grupit të punës të përbërë nga drejtuesit e OJF-ve lokale (pjesë e rrjetit) ku përfshihet dhe eksperti i jashtëm (i pavarur), i cili nuk duhet të jetë punonjës të administratës publike vendore.

b. Grupi i punës drejtohet nga Kryetari i organizatës partnere.

c. Plani i punës së grupit, duhet të bazohet në zbatimin e dokumentin metodologjisë, miratohet dhe ndiqet nga drejtuesi përgjegjës i organizatës dhe eksperti.

d. Vlerësimi dhe analizimi i të dhënave të anketimeve, sipas njësive administrative dhe në nivel bashkie.

e. Raporti dhe rekomandimet.

Anketimi përfshin 4 faza zbatimi:

FAZA I. – PËRCAKTIMI DHE STRUKTURIMI I PYETËSORIT

- Njohja e pyetësorit me grupin e punës dhe ekspertin.
- Përcaktimi i anëtarëve të OJF-ve të rrjetit që do të merren me lehtësimin e procesit të anketimit, sipas njësive administrative.
- Çdo anëtar do ti caktohet numri i pyetësorëve që do plotësoj me të anketuarin, sipas Njësive Administrative dhe grupeve të interesit.

FAZA II. – ZBATIMI I ANKETIMEVE NË NIVELIN E NJËSIVE ADMINISTRATIVE LOKALE

- Identifikimi dhe njohja e anëtarëve të grupit të punës me burimet që do të përdoren për identifikimin dhe vlerësimin e problematikave mjedisore dhe të burimeve natyrore.
- Identifikimi dhe organizimi i takimeve me individët dhe grupet e interesit që do të anketohen, sipas kërkesave të metodologjisë.
- Plotësimi i pyetësorit, sipas kërkesave të metodologjisë.

FAZA III. GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE TË PYETËSORIT NË NIVELIN E NJËSIVE ADMINISTRATIVE LOKALE

- Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave të pyetësoreve individual dhe përgatitja e rezultateve përmbledhës në nivel Nj.Ad.
- Hartimi i grafikëve dhe listës së problematikave mjedisore dhe për burimet natyrore.
- Përcaktimi i problematikës prioritare mjedisore në nivel Nj.Ad.
- Përgatitja e raportit dhe rekomandimet për problematikat mjedisore të edivencuara, bazuar në përmbledhjen e rezultateve të anketimit individual, në nivel Nj.Ad.

FAZA IV. – PËRPUNIMI I TË DHËNAVE TË PYETËSORIT NË NIVELIN E BASHKISË

- Grumbullimi i raporteve me të dhënat e problematikës mjedisore, në nivel NjAd dhe analizimi i tyre.
- Vlerësimi i raporteve dhe i listës së problematikave mjedisore, në nivel Nj.Ad.
- Përgatitja e raportit përfundimtar për identifikimin dhe vlerësimin e problematikave mjedisore dhe të burimeve natyrore, në nivel bashkie, bazuar në raportet në nivel Nj.Ad, si dhe të dhënave të tjera të siguruara nga ekserti.

Në fazën e hartimit të pyetësorit, për identifikimin e problematikës, duhet ndjekur dhe tentuar të arrihet në një lloj hulumtimi me një qasje të thjeshtë, por cilësore në një kontekst praktik

dhe real, bazuar kryesisht në metodën e takimit drejtpërdrejt me të anketuarin. Zgjedhja e formatit dhe e llojit të dhënave të kërkuara, është përputhur me mënyrën sesi do të përpunohen të dhënat e pyetësorit, sipas prioriteteve, shkallëve cilësore e sasiore dhe më pas në përgatitjen e raportit përfundimtar për secilën njësi administrative dhe në nivel bashkie.

Formulimi i pyetjeve është bazuar dhe ka ndjekur qëllimin për identifikimin e problematikave nga grupi i punës, me një gjuhë të thjeshtë, të kuptueshme dhe lehtësisë për mundësinë e shprehjes të përgjigjeve me synimin e marrjea së mendimeve të grupeve të ndryshme nga komuniteti i anketuar.

Gjithashtu, përmbajtja e pyetjeve është në harmoni me informacionin që është parashikuar për t'u mbledhur si dhe formën e komunikimit, që duhet të përdoret me të intervistuarin.

Pyetjet janë të qarta dhe nuk sjellin vështirësi për të intervistuarin. Të dhënat që kërkohen janë të karakterit përgjithësues, jo politikë, por të drejtpërdrejta dhe të kuptueshme për secilin grupmoshe që do të intervistohet.

Në hartimin e pyetjeve janë patur parasysh dhe diferencat në nivelin e të intervistuarëve mosha, profesioni, arsimit, interesi i tyre, lehtësia për zgjedhjen e përgjigjeve, si dhe shmangjen e keqkuptimeve apo dhe të reagimeve të tyre ndaj këtij pyetësi.

Pyetjet janë të thjeshta me një përgjigje "PO" ose "JO" ose "Nuk e di". Janë planifikuar pyetje dhe me zgjedhje alternative si dhe me shumë përzgjedhje nga i intervistuari, këto në vartësi të njohurive dhe vullnetit të tij. Pra, të intervistuarëve u jepet mundësi zgjedhjeje mes alternativave, për të marrë mendimin personal të të intervistuarëve rreth çështjes së administrimit dhe menaxhimit të problematikave të mjedisit dhe burimeve natyrore.

Lista e pyetjeve shoqërohet dhe me hapsira (kuti) për të shënuar me shënjen X apo duke e plotësuar me shkrim përgjigjen.

Administrimi i pyetësorit do të realizohet në mënyrë rastësore, në bazë të konsultave ditore të zhvilluara në secilën Njësi Administrative (Nj.Ad.) me të intervistuarit.

Për procesin e Anketim-Intervistimit, së pari, personi i ngarkuar dhe eksperti duhet të sigurojnë numrin e pyetësorëve që do të plotësohen nga anketuesit, sipas planifikimit të bërë për secilën Nj.Ad.

Të dhënat do të sigurohen nga plotësimi i pyetësorit nga anketuesi me ndihmën e personit të caktuar për të ndjekur këtë proces dhe të ekspertit, sipas ndarjes së bërë në nivel Njësie Administrative dhe metodologjisë.

Pyetësi u shpërndahet anketuesve sipas planifikimit dhe duhet të plotësohet nga vetë anketuesit pa u ndikuar. Personi i ngarkuar duhet të bëjë kujdes me vështirësitë që mund të hasin për realizimin e anketimit, të cilat lidhen kryesisht me koordinimin e përditshëm të takimeve, sipas grupmoshave. Në raste të veçanta anketuesi ndihmohet nga personi i ngarkuar për ndjekjen e këtij procesi. Gjatë intervistimit duhet bërë kujdes që të ruhet anonimiteti i të intervistuarëve.

Në përfundim të procesit të anketimit të gjithë pyetësit administrohen nga personi i ngarkuar, i cili, së bashku me ekspertin, kryejnë vlerësimin dhe analizimin e të dhënave të pyetësit individual.

Mbi bazën e tyre personi përgjegjës dhe eksperti hartojnë përmbledhësen e të dhënave në nivel Nj.Ad. Puna kryesore e këtij procesi është përcaktimi dhe listimi i të gjitha problemeve mjedisore dhe për burimet natyrore si dhe hartimi i raportit në nivel Nj.Ad.

Më pas të dhënat e rezultuara në nivel Nj.Ad dhe raporti dërgohen tek grupi kryesor i punës, i cili pas vlerësimit përgatit përmbledhjen e këtyre të dhënave, raportin dhe rekomandimet përkatëse në nivel bashkie.

3.ANKETIMI-INTERVISTIMI

Instrumenti kryesor i metodologjisë së pyetësorit është ”ANKETIMI-INTERVISTIMI”, i cili kryhet nga anëtarët e OJF-ve të rrjetit dhe ekspertit.

Për gjitha zonat pilote të përzgjedhur, duhet potësuar jo më pak se **475 pyetësor**, të ndarë në 5 rubrika, nga të cilat: Bashkia Divjakë **125** copë; Bashkia Has **100** copë dhe Bashkia Lezhë **250** copë.

“Pyetësor-Anketimi” do shtrihet në të gjithë territorin e bashkisë, sipas ndarjes së Njësive Administrative (Nj.Ad), si më poshtë.

Bashkia DIVJAKË

Njësia Administrative	Nr.Pyetësorëve nga të cilët:	Të Rinj	Femra	Meshkuj	Punonjës publik	Anëtar të OJF
Divjakë	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5
Grabian	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5
Gradishtë	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5
Remas	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5
Tërbuf	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5

Bashkia HAS

Njësia Administrative	Nr.Pyetësorëve nga të cilët:	Të Rinj	Femra	Meshkuj	Punonjës publik	Anëtar të OJF
Fajzë	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5
Gjinaj	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5
Golaj	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5
Krumë	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5

Bashkia LEZHË

Njësia Administrative	Nr.Pyetësorëve nga të cilët:	Të Rinj	Femra	Meshkuj	Punonjës publik	Anëtar të OJF
Ballëdren	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5
Blinisht	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5
Dajç	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5
Kallmet	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5
Kolsh	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5
Lezhë	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5
Shëngjin	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5
Shënkoll	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5
Ungrej	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5
Zejmen	10 - 25	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5	1 - 5

Të dhënat e pyetësorit përmbajnë **22 pyetje**, që prekin 3 zonat pilote të përzgjedhura. Në krye të pyetësorit vendoset:

Emri i Organizatës partnere të projektit “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”.

Emri i OJF-s së rrjetit të përfshirë në procesin e anketimit.

Koha e kryerjes së intervistës.

3.1 PËRGJIGJA E PYETJES:

Pyetja 1: Duhet marrë në konsideratë grupmoshat që përfshihen në anketim, ku kërkohen përgjigje nga të Rinjtë; Femra, Meshkuj, Administrata publike dhe Anëtar të OJF-ve. Gjithashtu, anketuesit i kërkohet të vendos Profesionin dhe Arsimin. Për çdo përgjigje duhet të vendoset **shenja X**, në kutinë përkatëse.

Pyetja 2: Anketuesi shpreh mendimin e tij për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit natyror, duke vendosur **shenjën X**, në njerën prej rubrikave të caktuara.

Pyetja 3: Anketuesi shpreh mendimin e tij për planin e veprimit për mjedisin të miratuar nga bashkia, duke vendosur **shenjën X**, në njerën prej rubrikave të caktuara. Në rast **PO**, duhet të shprehet si është zbatuar ky plan, duke vendosur **shenjën X**, në njerën prej rubrikave të caktuara.

Pyetja 4: Anketuesi shpreh mendimin e tij nëse problemet mjedisore janë prioritare në politikat vendore, duke vendosur **shenjën X**, në njerën prej rubrikave të caktuara.

Pyetja 5: Anketuesi shpreh mendimin e tij nëse administrata e bashkisë organizon takime për ruajtjen dhe administrimin e burimeve natyrore, duke vendosur **shenjën X**, në njerën prej rubrikave të caktuara.

Pyetja 6: Anketuesi shpreh mendimin e tij për punën e strukturave të bashkisë në lidhje me ruajtjen dhe administrimin e burimeve natyrore, duke vendosur **shenjën X**, në njerën prej rubrikave të caktuara.

Pyetja 7: Anketuesi shpreh mendimin e tij nëse është i përfshirë në punët dhe problemet mjedisore, duke vendosur **shenjën X**, në njerën prej rubrikave të caktuara.

Pyetja 8: Anketuesi shpreh mendimin e tij nëse ka marrë pjesë në ndonjë aktivitet ku janë trajtuar problemet mjedisore, duke vendosur **shenjën X**, në njerën prej rubrikave të caktuara. Në rast **PO** duhet të listoj llojet e aktiviteteve ku ka marrë pjesë.

Pyetja 9: Kjo pyetje kërkon përgjigje vetëm nga **anëtarët e OJF-ve** pjesë e rrjetit dhe të tjera, duke vendosur **shenjën X**, në njerën prej rubrikave të caktuara. Në rast **PO**, duhet të listohen llojet e aktiviteteve ku ka marrë pjesë.

Pyetja 10: Anketuesi shpreh mendimin e tij për zbatimin e ligjshmërisë në lidhje me ruajtjen dhe përdorimin e burimeve natyrore, duke vendosur **shenjën X**, në njerën prej rubrikave të caktuara.

Pyetja 11: Anketuesi shpreh mendimin e tij për rastet e korrupsionit dhe krimin mjedisor në lidhje me burimet natyrore, duke vendosur **shenjën X**, në njerën prej rubrikave të caktuara. Në rast **PO**, duhet të përshkruaj llojin, shtrirjen dhe kush është përgjegjës nga institucionet në nivel lokal.

Pyetja 12: Kjo pyetje kërkon përgjigje vetëm nga **anëtarët e OJF-ve** pjesë e rrjetit dhe të tjera, duke përshkruar nismat e organizatës për parandalimin, luftimin dhe adresimin e rasteve korruptive në përdorimin e burimeve natyrore.

Pyetja 13: Anketuesi shpreh mendimin e tij dhe liston vlerat më të rëndësishme mjedisore e natyrore që gjenden në territorin e bashkisë.

Pyetja 14: Anketuesi shpreh mendimin e tij dhe liston përfitimet më të rëndësishme social-ekonomike dhe ekoturistike që gjenden në territorin e bashkisë, për komunitetin lokal.

Pyetja 15: Anketuesi shpreh mendimin e tij dhe liston problemet me ndikim negativ që dëmtojnë mjedisin, natyrën, biodiversitetin dhe peizazhin.

Pyetja 16: Anketuesi shpreh mendimin e tij duke listuar veprimtaritë dhe shenjën X, të rubrikat e caktuara për veprimtaritë sipas impaktit të tyre, duke patur parasysh:

1. **Impakt tjetërsues i parikthyeshëm**, ku masat e marra nuk mund të rehabilitojnë dhe ta kthejnë në gjendjen e më parshme. P.Sh..Minierat, Guroret, HEC etj.

2. **Impakt shumë i rëndë**, kur dëmtimi është deri në 90%, dhe kërkohen shumë fonde dhe kohë për risjelljen e dëmtimit në gjendjen e më parshme. P.Sh.. Prerja dhe djegja e pyjeve, Shkaderimi apo dëmtimi i tipave të habitateve, etj.

3. **Impakt i rëndë**, kur dëmtimi është deri në 70%, dhe kërkohen shumë fonde dhe kohë për përmirësimin e situatës. P.Sh..Grumbullimi dhe shkulja e bimëve mjekësore, ndotja e mjedisit,etj.

4. **Impakt mesatar**, kur dëmtimi është deri në 50%, dhe kërkohen fonde dhe përmirësimi i situatës është plotësisht i mundshëm;

5. **Impakt i dobët**, kur dëmtimi është deri në 20%.

Pyetja 17: Anketuesi shpreh mendimin e tij dhe liston se cilët janë shkaqet kryesore të ndikimeve negative në mjedis.

Pyetja 18: Anketuesi shpreh mendimin e tij dhe liston se cilët janë shkaktarët e dëmtimit dhe ndotjes së mjedisit. P.Sh Industria nxjerrëse dhe përpunuese, Infrastruktura, Bujqësia, Turizmi masiv, Banorët, etj.

Pyetja 19: Anketuesi shpreh mendimin e tij dhe përcakton 2 prioritete më të domosdoshme të problematikave në mjedis dhe burimet natyrore, të cilat duhen bërë prezent në strukturat e bashkisë apo/dhe në autoritetet e tjera shtetërore në nivel lokal.

Pyetja 20: Anketuesi shpreh mendimin e tij dhe liston problemet me të cilat ndeshet zona e mbrojtur.

Pyetja 21: Anketuesi shpreh mendimin e tij në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese, edukuese, për promovimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. duke vendosur shenjën X, në njerën prej rubrikave të caktuara. Në rast **PO**, duhet të listoj se cilat janë aktivitetet e kryera.

Pyetja 22: Anketuesi shpreh mendimin e tij nëse problematikat ruajtjes dhe e menaxhimit të mjedisit dhe të burimeve natyrore janë trajtuar në mediet lokale, duke vendosur shenjën X, në njerën prej rubrikave të caktuara. Në rast **PO**, duhet të listoj se cilat janë problemet e trajtuara.

4.PËRGJITHËSIME MBI PROBLEMATIKAT NË MJEDIS DHE NË BURIMET NATYRORE – ANALIZA NË KUADËR TË GRUPEVE TË INTERESIT NË ZONAT PILOTE

Përdorimi racional i burimeve natyrore dhe mbrojtja e mjedisit është një nga problemet më të rëndësishme të shoqërisë moderne në epokën e përparimit shkencor dhe teknologjik, i shoqëruar nga një ndikim aktiv në natyrë.

Aktualisht, problemi i varfërimit të burimeve natyrore po bëhet gjithnjë e më i mprehtë. Shkarkimi i potencialit të burimeve natyrore shprehet në pakësimin e burimeve natyrore në një nivel që nuk plotëson nevojat e njerëzimit, aftësitë e tij teknike dhe standardet e sigurisë për sistemet natyrore.

Shkatrimi i burimeve natyrore e bën zhvillimin e mëtejshëm të tyre ekonomikisht dhe ekologjikisht jopraktik.

Menaxhimi tradicional i natyrës supozon zhvillimin të qëndrueshëm të burimeve natyrore, parandalimin e pasojave të mundshme të dëmshme të veprimtarisë njerëzore, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e produktivitetit dhe atraktivitetit të komplekseve natyrore dhe objekteve natyrore individuale.

Përdorimi racional i burimeve natyrore përfshin zgjedhjen e opsionit optimal për arritjen e efekteve mjedisore, ekonomike dhe sociale gjatë përdorimit të burimeve natyrore.

Përdorimi i integruar i burimeve natyrore përfshin përdorimin e teknologjive pa mbetje dhe me pak mbetje, ripërdorimin e burimeve dytësore.

Elementet e nevojshme të menaxhimit të qëndrueshëm të natyrës janë:

- mënyrat optimale të konsumit të llojeve të burimeve dhe përdorimi kompleks i tyre;
- duke marrë parasysh shpejtësinë dhe vëllimin e rinovimit të burimeve;
- menaxhimi i riprodhimit të thjeshtë dhe të zgjeruar të burimeve;
- ruajtja e cilësisë së peizazhit të përdorur (ekosistem);
- bllokimin dhe eliminimin e pasojave negative të kapjes së burimeve natyrore;
- organizimi i industrive më ekonomike dhe fitimprurëse, duke marrë parasysh funksionimin natyror dhe dinamikën e ekosistemeve.

Nga pikëpamja e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, potenciali i burimeve natyrore nuk është një rezervë absolutisht maksimale e burimeve, por vetëm ai kufi që mund të përdoret pa dëmtuar ndjeshëm vetitë dhe funksionet më të rëndësishme të ekosistemeve. Prandaj, përpara se të fillojë përdorimi i ekosistemit, duhet të përcaktohet një masë për largimin e materies dhe energjisë, e cila nuk cenon aftësinë e tij për vetërregullim dhe vetë-rikuperim. Përndryshe, përdorimi do të jetë spontan, pavarësisht natyrës së planifikuar në dukje.

Me menaxhimin racional të natyrës, ngarkesa antropogjene nuk duhet të kalojë nivelin e stabilitetit të ekosistemit (*kapaciteti ekologjik i territorit*). Si rregull, në kushtet e zhvillimit të teknogjenezës, kapaciteti ekologjik i një territori është një tregues kufizues. Aktualisht

menaxhimi mjedisor kryhet mbi baza administrative-territoriale, natyrore-gjeografike, pellgësh. Në të njëjtën kohë, këto shenja nuk janë gjithmonë të zbatueshme për sektorët e tjerë të ekonomisë.

Sistemi i përdorimit të baraspeshuar të burimeve natyrore në raport me çdo pasuri natyrore përfshin disa nënsisteme të ndërlidhura: monitorimin e gjendjes së florës, ruajtjen dhe restaurimin e mbulesës bimore, përdorimin e burimeve bimore, kontrollin dhe mbikëqyrjen. Qëllimi i organizimit të çdo sistemi është zhvillimi dhe zbatimi i mekanizmave organizativë, ligjorë, financiarë dhe ekonomikë të bazuar shkencërisht në këtë fushë.

Funksionet e kontrollit shtetëror (qendror e vendor), në përputhje me legjisllacionin, janë të një rëndësie të veçantë, pasi burimet natyrore janë një pronë kombëtare, të parashikuara në Kushtetutë dhe janë të detyruar të sigurojnë përdorimin baraspeshuar të burimeve natyrore, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e saj nga ndikimi negativ i mjedisit të ndotur, i cili mund të shfaqet në formën e ndikimit të faktorëve të rrezikshëm mbi shëndetin njerëzor e të gjallesave të tjera, mbi gjendjen e objekteve të prodhimit dhe rrjedhën e proceseve teknologjike. Mosrespektimi i këtyre detyrimeve duhet të sjellë pasoja të rënda juridike dhe ekonomike për ndërmarrjen shkelëse.

Përdorimi i baraspeshuar i burimeve natyrore është një ndikim i vazhdueshëm i një personi në hapësirën përreth, ku ai di të menaxhojë marrëdhëniet me natyrën në bazë të ruajtjes dhe mbrojtjes së saj nga pasojat e padëshiruara gjatë veprimtarisë së tij.

Përdorimi i baraspeshuar i burimeve natyrore nënkupton ndërveprimin e të gjithë sistemit natyror në bazë të ruajtjes së ligjeve të ekologjisë, racionalizimit të përdorimit, ruajtjes dhe shtimit të burimeve të disponueshme. Thelbi i menaxhimit të natyrës bazohet në ligjet parësore të sintezës së ndërsjellë të sistemeve të ndryshme natyrore. Kështu, menaxhimi racional i natyrës kuptohet si analiza e një biosisteme, funksionimi i kujdesshëm, mbrojtja dhe riprodhimi i tij, duke marrë parasysh jo vetëm interesat aktuale, por edhe të ardhshme të zhvillimit të sektorëve ekonomikë dhe të ruajtjes së shëndetit të njeriut.

Gjendja aktuale e menaxhimit të natyrës tregon një qasje irracionale që çon në shkatërrimin e ekuilibrit ekologjik dhe rikuperim shumë të vështirë nga ndikimi njerëzor. Përveç kësaj, shfrytëzimi i gjerë i bazuar në teknologjitë e vjetra ka çuar në një situatë në të cilën mjedisi është në një gjendje të ndotur dhe depresive. Shembuj të përdorimit të paqëndrueshëm të burimeve natyrore:

- Bujqësia e pakontrolluar dhe intensive.
- Formimi i përrenjve, erozioni i tokës dhe shkatërrimin e shtresës pjellore të tokës (humus).
- Ndryshimi i regjimit hidrogjik dhe erozioni bregdetar.
- Shpyllëzimi dhe djegja.
- Shkatërrimi i zonave të mbrojtura dhe me vlera mjedisore e të biodiversitetit.
- Mbipeshkimi dhe mbikullotja.
- Shfarosja e llojeve të vlefshme të bimëve, kafshëve dhe peshqve.
- Derdhja e mbetjeve dhe ujërave të zeza në lumenj, liqene, dete, ligatina, ujëmbledhës, pyje, etj.

- Ndotja e tokës dhe atmosferës nga kimikatet.
- Miniera, Gurore dhe shfrytëzimi i inerteve.

Gjithashtu, një problem edhe më i mprehtë është shterimi i burimeve të pa rinovueshme, si dhe akumulimi në mjedisin natyror i një sasive të madhe mbetjesh prodhimi dhe konsumi. E gjithë kjo dëshmon për përdorimin jo të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Natyra e marrëdhënies midis natyrës dhe njeriut ka ndryshuar gjatë rrjedhës së historisë. Problemi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore është shumë më i gjerë dhe më kompleks sesa mund të duket në shikim të parë. Duhet mbajtur mend se gjithçka në natyrë është e ndërlidhur ngushtë dhe asnjë nga përbërësit e saj nuk mund të ekzistojë i izoluar nga njëri-tjetri.

Shfrytëzimi i barazpeshuar i burimeve natyrore nënkupton një mënyrë të tillë të shfrytëzimit të mjedisit natyror, në të cilin ndërveprimi në sistemin “*njeri-natyrë*” mbetet maksimalisht i harmonizuar.

Konceptet e "ekologjisë" dhe "përdorimit qëndrueshëm të burimeve natyrore" janë praktikisht identike. Të ashtuquajturat paradigma të menaxhimit të natyrës ekologjike mund t'i zbulojnë ato më qartë. Janë tre prej tyre:

1. Minimizimi i ndikimit të njeriut në natyrë në procesin e përdorimit të burimeve natyrore.
2. Përdorimi optimal (i plotë) i një burimi specifik.
3. Shfrytëzimi maksimal i një burimi të caktuar natyror për të përmirësuar mirëqenien e shoqërisë.

Përdorimi tradicional i burimeve natyrore dhe mbrojtja e natyrës janë koncepte jashtëzakonisht të rëndësishme në pragun e mijëvjeçarit të ri. Njerëzimi për herë të parë mendoi seriozisht për pasojat e aktiviteteve të tij dhe për të ardhmen e planetit tonë. Dhe është shumë e rëndësishme që parimet dhe deklaratat teorike të mos ndryshojnë nga veprat reale. Kjo kërkon që çdo banor i Tokës të kuptojë rëndësinë e sjelljes korrekte dhe të mendojë me kujdes.

Në varësi të situatës specifike, disponueshmëria e burimeve të caktuara, gjendja e mjedisit natyror, profili shtetëror, standardi i jetesës së popullsisë, zhvillimi i teknologjive, etj., këto fusha të menaxhimit të qëndrueshëm të mjedisit janë të specifikuara për zbatim praktik në formën e masave dhe veprimeve specifike, si:

1. **Kursimi i burimeve**, në radhë të parë në proceset e prodhimit, d.m.th. duke reduktuar intensitetin e burimeve të tyre.
2. **Natyra intensive e menaxhimit të natyrës**, ku përparësi nuk duhet t'i jepet natyrës së gjerë (intensive) të menaxhimit, por asaj tradicionale dhe të bashkëintegruar.
3. **Natyra komplekse e përdorimit të burimeve natyrore**, burimet natyrore duhet të nxirren një herë për shfrytëzimin e tyre të integruar, dhe jo çdo herë për të përfutur një nga elementët e tyre.

4. **Cikliteti dhe prodhimi me pak mbetje.** Vëmendje më e madhe duhet t'i kushtohet ripërdorimit të burimeve natyrore, gjë që lejon kursimin e lëndëve të para dhe energjisë primare, si dhe reduktimin e sasisë së mbetjeve të ngurta.
5. **Përdorimi i burimeve natyrore,** duhet të shoqërohet me restaurimin ose zëvendësimin e tyre.
6. **Ruajtja dhe përmirësimi i cilësisë së kushteve natyrore.** Vëllimet dhe përqendrimet e ndotësve që hyjnë (shkarkohen) në biosferë nuk duhet të kalojnë nivelet e lejuara në të cilat ekosistemet natyrore thithin dhe përpunojnë këto substanca pa u degraduar.
7. **Përdorimi i burimeve natyrore,** duhet të kryhet duke marrë parasysh kushtet natyrore dhe socio-ekonomike lokale.

4.1 Çfarë mund të veçojmë nga problematika dhe ndikimet për analizën në zonat pilote?

Shqipëria ka një natyrë/peizazh të fragmentuar, i cili është nën presionin në rritje nga kërkesat konkurruese për shfrytëzimin e tokës, ndryshimet klimatike dhe menaxhimin e pamjaftueshme. Ekziston gjithashtu një nevojë për të ruajtur e menaxhuar më të gjerë mjedisin, të gjitha burimet natyrore përfshi edhe ZMM në aspektin e rëndësisë për trashëgiminë natyrore të Evropës, njerëzve dhe komuniteteve të saj. Kjo arrihet nëpërmjet ndryshimit të mendësive, ka mundësi të mëdha për kursimin e biodiversitetit dhe nuk është fakultative se si është përdorur, se si janë menaxhuar burime natyrore, përparësitë se cila është qasje më e mirëintegruar dhe mekanizma më të reja të financimit.

Shqipëria mbart një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë natyrore të Evropës dhe përfaqëson një ndër vendet e para përse i përket sipërfaqes me vlera të larta natyrore, në raport me sipërfaqen totale të vendit. Ruajtja e natyrës, ndonëse nuk ka marrë vëmendjen e duhur në tërësinë e prioriteteve të integritit, përfaqëson një kusht të rëndësishëm në kuadër të këtij procesi. Edhe pse ka zona të mbrojtura dhe projekte të ndryshme janë duke u kryer, Shqipëria nuk ka hartuar ende një inventar të plotë të të dhënave mbi biodiversitetin, që mund të përdoren për planifikimin e zonave të tjera të mbrojtura.

Rruga e ndjekur në gjithë këtë periudhë tranzicioni për shfrytëzimin e pasurive natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit ka qënë shumë shkatruese, me gjurmë tepër mbreslënëse, në shumë raste të pakthyeshme, me shumë kosto dhe pasoja të rënda në ekonominë e vendit, por dhe në vetë shëndetin e njeriut.

Përdorimi i mekanizmave ekonomik-financiar në politikat mjedisore mbetet ende i zbehtë. Mungon nxitja e prodhimeve të pastra apo e bizneseve që respektojnë standartet mjedisore, ashtu si edhe penalizimi i atyre që nuk respektojnë këto standarte. Tarifat, gjobat ose taksat dhe subvencionet (insentivat) që lidhen me mjedisin nuk shkojnë të gjitha në përmirësimin e situatës mjedisore. Praktikrat më të mira të Bashkimit Evropian (BE) nuk gjejnë zbatim për investimet me impakt në mjedis, për të kufizuar ndikimet e tyre, për mirëmbajtjen e tij dhe për kontribute të tjera sociale.

Bashkëpunimi me institucionet menaxhuese përbën pikën më kritike të problematikës mjedisore dhe trajtimit të saj nga qeverisja vendore, por edhe nga ministrinë përgjegjëse. Menaxhimi institucional lë për të dëshiruar dhe vihen re abuzime të konsiderueshme. Shpesh janë gjendur mekanizma për të anashkaluar kuadrin ligjor dhe për të vazhduar shfrytëzimin barabar të pyjeve. Nuk kanë qënë të plota dhe rezultative programet në shfrytëzimin e pyjeve, në mbrojtjen dhe të përdorimit të qëndrueshëm të tyre. Për shkak të prerjeve masive është shfaqur fenomeni i përmytjeve dhe prurjeve të vrullshme të përrenjeve dhe lumenjeve, duke transportuar sasira të mëdha inertesh në basenet e hidrocentraleve apo të ujit të pijshëm. Këtyre veprimeve, megjithëse të ndaluara me ligj, në mjaft raste nuk u kanë shpëtuar dhe disa nga zonat e mbrojtura.

Për shkak të dinamikës intensive dhe kaotike të zhvillimit urban, varfërisë, mungesës së stimujve ekonomikë për ruajtjen, zhvillimin dhe përdorimin e burimeve natyrore, gjendja e mjedisit paraqitet me tregues jo të kënaqshëm. Në përkeqësimin e tyre kanë luajtur rol mosndërhyrjet në ndotjet e trashëguara, praktikat spontane të pakontrolluara e të patrajtura në fushën e shkarkimeve urbane, rurale dhe industriale, si dhe mungesa e një sistemi të fortë për kontrollin e tyre. Mbi të gjitha, vërehet se problematika mjedisore nuk konsiderohet ende si prioritet në hartimin e politikave ekonomike të zhvillimit të vendit. Është kjo një nga arësyet që Shqipëria paraqitet me burime natyrore më të degraduara në rajon dhe kjo situatë ende vijon të jetë problematike, në rast se nuk merret përsipër të ruajmë atë që ka mbetur dhe të rehabilitojmë maksimalisht atë që është dëmtuar.

Rritja e popullsisë dhe zhvillimi i turizmit në këto zona ka diktuar kursin e zhvillimeve jo gjithmonë pozitive: si kaosi urban, ndotja urbane e cila ka njohur rritje të ndjeshme, vështirësitë në kontrollim dhe monitorimin e situatës etj. Peizazhi dhe mjedisi paraqitet i rënduar gjatë gjithë territorit të vendit duke degraduar panoramën me ndërtime të realizuara në mungesë të një planifikimi kombëtar e sektorial.

Erozioni është gjithashtu një faktor problematik që ka ndikim në panoramën e përgjithshme. Krahas faktorëve natyrorë, është favorizuar nga aktiviteti njerëzor në mënyrë abuzive për qëllime ndërtimi, etj. Humbja e tokës vijon të mbetet problem mjaft shqetësues dhe kompleks. Gërryerja e tokës nga forca e lumenjve dhe përrenjve është një tjetër aspekt i rëndësishëm i këtij shqetësimi madhor. Materiale e ngurta derdhen në det, liqene e laguna, si rezultat i dëmtimit të mbulesës bimore (prerjet dhe diegja e pyjeve, kullotave) jemi dëshimtar të shkarjeve masive të tokës dhe të përmytjeve, që rrezikojnë mjaft qendra të banuara dhe fshatra malore. Ndotja është një tjetër fenomen mjaft i pranishëm edhe për tokën.

Ka raste që ndryshohet destinacioni kryesor i përdorimit të tokës bujqësore dhe të habitateve natyrore, duke i kthyer në truall ndërtimor, për objekte turistike, ndërtimin e banesave dhe lokaleve, fusha sportive apo edhe infrastrukturore. Kjo praktikë ka rezultuar me humbjen e habitateve natyrore, të biodiversitetit, ka ndotur mjedisin dhe ka prishur vlerat estetike të peisazhit

Sipërfaqja me bimësi pyjore dhe kullotat mbulojnë rreth 36% të territorit të vendit. Në këto 30 vitet e fundit, siç dihet, gjendja dhe menaxhimi i pyjeve është përkeqësuar dhe ka arritur

në një pikë katastrofike. Prerjet e paligjshme në pyje kanë qënë mjaft prezente dhe asnjëherë nuk ka pasur vullnet për ta paraqitur realisht këtë gjendje. Humbja e sipërfaqes pyjore është shoqëruar me dukuri të tjera si ngritja e temperaturës së ajrit, gërryerjet e tokës, humbja e habitateve për florën dhe faunën e egër, peizazhin, etj.

Shqipëria ka rreth 30 vite që është në emergjencë kombëtare, veçanërisht situatës në pyje dhe kullota, duke iu rikthyer zjarreve masive që janë lajm prej vitesh në stinën e verës. Një ndër faktorët që kushtëzon regjimin e zjarrit është mjedisi, për sa i përket kushteve klimatike, morfologjike, përdorimet e tokës dhe aspektet socio-ekonomike të lidhura me praninë e njeriut në territore të cilët vetë-përcaktojnë regjimin e zjarrit. Arsytet e rënies së zjarreve janë nga më të ndryshmet, por në 99% të rasteve të shfaqjes së këtyre zjarreve si shkak paraqitet njeriu (në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose jo). Motivët e këtyre zjarreve janë nga më të ndryshmet. Zjarret e qëllimshme bëhen me qëllim të zgjerimit të tokës së punueshme apo kullotat, ku njeriu ndez zjarrin pa llogaritur pasojat.

Sipas të dhënave parësore, të grumbulluara nga emergjencat civile në nivel qarku, numri më i lartë i hektarëve të djegur rezulton për qarkun Vlorë, Kukës, Fier, Gjirokastrë, etj.. Zjarret nuk po kursejnë zonat e mbrojtura, ullishtet, vreshtat, agrumet dhe pëmtoret.

Konstatohet se për problemin e menaxhimit të zjarreve jemi tërësisht të papërgatitur nga të gjitha strukturat e ngarkuara dhe përgjegjëse. Kjo situatë është shumëvjeçare dhe nuk po ndryshon.

Vërehet se institucionet shtetërore qendrore si dhe ato lokale janë përfshirë në mënyrë të pamjaftueshme për parandalimin dhe kontrollin e zjarrit dhe kapacitetet e tyre janë mjaft të dobëta. Pushtreti vendor është tërësisht i papërgatitur për të përballuar këto situata. Nuk jemi të përgatitur për luftën me zjarret. Megjithëse ngrihet shtabi i emergjencave mungon ngritja e skuadrave vullnetare të sinjalizimit-vrojtimit.

Kodi penal parashikon masa të rënda dënimi për vendosjen e qëllim të zjarrit në pyje, kullota e pëmtore. Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës me zjarr dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet. Kur nga vepra penale janë shkaktuar pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim deri në dhjetë vjet. Por rastet e dënimit të shkaktarëve janë shumë të pakta, për të mos thënë asnjë.

Minierat, guroret, germimet dhe HEC janë bërë një shqetësim për humbjen dhe coptimin e habitateve, zhdukjen e llojeve floristike e faunistike, ndotjen, peizazhin e përkeqësuar, duke qënë shëmbull i keqpërdorimit, i tjetërsimit, i zënies dhe i shfrytëzueshmërisë së padëshiruar të tokës, pyjeve e ujërave, të cilat kanë prekur edhe rrjetin e zonave të mbrojtura mjedisore, të cilat konsiderohet tepër e dëmshme dhe e pa ranueshme për standartet ndërkombëtare.

Ndotja e mjedisit, pyjeve, det-bregdetit, liqeneve e lagunave, lumenjve e përrenjve, zonave të mbrojtura dhe ato me përparësi të turizmit, qendrat urbane e rurale etj, lë shumë për të dëshiruar. Në shkallë kombëtare vlerësohen mijëra ton plehra në vit. Përbërësit më të rëndësishëm të mbetjeve janë ato organikë. Industria e ndërtimit dhe prishjet e ndërtimeve pa

leje, të cilat nuk kanë venddepozitime të posaçme dhe në shumicën e rasteve përfundojnë në vedngrumbullimet e mbetjeve urbane.

Vendet e grumbullimi janë të pastudjuara. Ka edhe raste kur ato ndodhen pranë burimeve ujore që furnizojnë popullsinë ose pranë lumenjëve e përrenjëve, nëpër pyje e laguna, duke përbërë rrezik të madh kontaminimi. Kjo dukuri po bëhet shqetësim edhe për rrjetin e zonave të mbrojtura të vendit, veçanërisht në situatën e shtimit të numrit të vizitorëve në to apo dhe të shërbimeve.

Problemet më të mëdha në administrimin e mbetjeve janë pikat fundore, ku në masën dërrmuese njësitë e qeverisjeve vendore nuk kanë një leje mjedisore për vend depozitimet e mbetjeve. Të gjitha pikat e grumbullimit të tyre në qytetet e zonat rurale janë kthyer në Hot Spote, duke përbërë një rrezik për jetën e banorëve. Në to shkarkohen mbetjet e zakonshme, ato të rrezikshme e toksike, bateri, kimikate, medikamente e deri mbetje të rrezikshme spitalore. Nuk ka tentativa serioze për klasifikimin e mbeturinave dhe të riciklimit të tyre. Bëhen përpjekje për ndarjen e tyre në burim, por rezultatet janë për të dëshiruar.

Ende nuk punohet dhe nuk po gjen zbatim alternativa e fillimit të ndarjes së mbetjeve në burim konform standardeve për administrimin e tyre.

Për të eleminuar këtë situatë është ndërmarrë edhe aksioni kombëtar të “Pastrojmë Shqipërinë”.

Problematika evidencohen dhe për burimet ujore që përdoren për nevoja urbane, industriale, në sektorin bujqësor si edhe për prodhim hidroenergjie. Shqipëria nuk ka ende sisteme të mjaftueshme të trajtimit të ujrave të zeza e të përdorura, duke i shkarkuar ato direkt në ujra sipërfaqësore dhe në dete, liqene, ligatina, lumenjë, përrenjë, rezervuare, pyje, anës rrugëve dhe kudo. Lumenjtë e vendit kanë pësuar presionin më të madh nga aktiviteti njerëzor.

Në mjaft qytete e zona rurale për shkak të infrastrukturës së amortizuar ka përzierje të ujrave të zeza, të përdorura me ujin e pijshëm. Industria është kontribues në rritje të shkarkimeve ndotëse në ujrat sipërfaqësore dhe në tokë. Ndotja më e evidente vjen nga industria ushqimore, e materialeve të ndërtimit dhe e lëkurëve. Shumica e tyre aplikojnë teknologji të vjetër.

Urbanizimi dhe shtimi i ndotjes nga mbetjet urbane, rurale, bujqësia e industria ka sjellë përkeqësimin e cilësisë së tokës, pyjeve, ujërave dhe peisazheve.

Në shumicën e lumenjve dhe të trupave ujore niveli i ndotjes është në përmasa alarmante, me përmbajtje të përqëndrimeve të larta fenolesh, amoniumit, nitriteve etj.. Po kështu ndotja industriale minerare vazhdon të mbetet një faktor konstant në prishjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore/nëntokësore.

Problematikë tepër shqetësuese mbetet shfrytëzimi i skajshëm i pyjeve, varfërimin e skajshëm të faunës, të bimëve aromatiko-mjekësore, përdorimin pa kriter të tokës bujqësore, urbanizimin, ndotjen e saj nga përdorimi pa kriter i plehrave kimike dhe pesticideve, ndotjen

nga ujërat e shkarkimit, nga mbetjet urbane dhe industriale, pushtimin e brezit të dunave bregdetare, ndërtimin në zonat e mbrojtura, dhe së fundi shfrytëzimin e tejskajshëm të lumenjve për hidroenergjetikë.

Në shumicën e rasteve janë të dukshme shkeljet flagrante të ligjeve kombëtare dhe standardeve të institucioneve financiare ndërkombëtare. Disa nga këto shkelje kanë shkaktuar dëmtime të rënda në florën e faunën e zonave, konflikte të komunitetit me të drejtat mbi ujën, të cilat janë pasojë e mungesës së ujit.

Fakti i prerjes së pyjeve, shkatërimit të mbulesës vegjetative, tjetërsimi i fondit pyjor e kullosor, tejshfrytëzimi i burimeve natyrore, gjuetia, burgosja, ballsamimi, tregtimi, zbukurimi dhe përndjekja e llojeve të faunës së egër, qofshin këto dhe me status mbrojtës kombëtar apo ndërkombëtar, kompromentojnë rëndë qëllimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi dhe të Kodit Penal (KoP).

Prania e njerëzve pranë habitateve të bimëve dhe kafshëve të ndryshme në zonat me vlera natyrore, praktikat e menaxhimit jo të qëndrueshëm të peshkimit, praktikat bujqësore intensive dhe përdorimi i pesticide e plehrave, tejshfrytëzimi i burimeve natyrore apo zhvillime social-ekonomike e turistike masive kanë sjellë pasoja shpesh të pakthyeshme në menaxhimin e ZMM deri në dëmtimin, modifikimin, shkatërimin dhe copëtimin e tyre dhe të peisazhit.

Kësisoj, shumë nga habitatet natyrore janë dëmtuar ose janë copëzuar, duke shkatëruar florën dhe vendqëndrimet dhe ushqimin për mjaft lloje të faunës së egër. Prerja dhe djegia e pyjeve, tharja e zonave ligatinore, urbanizimi i sipërfaqeve të tokës, ndërtimet në zonat bregdetare e bregliqenore, ndotjet e ujit e tokës, cënimi i zonave malore, etj, janë problemet kryesore në lidhje me dëmtimet e habitateve dhe të biodiversitetit në përgjithësi.

Natyra, biodiversiteti, ZMM, peizazhi dhe burimet biologjike mbeten të kërcënuara për shkak të keqpërdorimit, tej shfrytëzimit dhe menaxhimit jo të mirë të këtyre burimeve me vlera të mëdha ekonomike, por edhe mjedisore e sociale. Këto probleme e impakte janë bërë shumë evidente në dekadat e fundit si rrjedhojë e përdorimit intensiv të burimeve natyrore për qëllime të përfitimit ekonomik.

Ndryshimet klimatike, rreziqet natyrore, ortekët, përmytjet, rrëshitjet, tërmetet, janë faktor kërcënues në nivel global, por dhe në nivel lokal për larminë biologjike.

Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore në Shqipëri nuk është i integruar ende si duhet në politikën kombëtare dhe lokale. Përfshirja e komuniteteve lokale në ruajtjen e natyrës dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura, ka ende një rrugë të gjatë për të kryer. Komunitetet lokale, në shumicën e rasteve, nuk arrijnë të prekin përfitimet socio-ekonomike që rrjedhin nga menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore në zonat e mbrojtura mjedisore. Mos përfshirja dhe ndarja jo e drejtë e përfitimeve vjen përgjithësisht si pasojë e kapaciteteve të ulëta dhe mungesës së njohurive në grupet e komunitetit lokal dhe mungesës së koordinimit midis organizatave të shoqërisë civile që i përfaqësojnë. Aktualisht, kjo situatë pengon zbatimin efektiv të politikave të ruajtjes së mjedisit dhe natyrës, dhe lehtësisht çon në

konflikte dhe keqkuptime, veçanërisht me komunitetet lokale, të cilat jetojnë në rajonet me vlerat më të larta të biodiversitetit në vend.

Ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e publikut janë çelsi i suksesit të gjithë përpjekjeve për përmirësimin e situatës mjedisore në vend. Mungon ndërgjegjësimi nëpërmjet shëmbujve konkretë, si edhe politika financiare e mbështetjes së OJF mjedisore, sikurse ndodh në vendet e tjera. Nuk ka një program real për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, ku duhet të përfshihen medoemos ministritë, pushteti lokal, shoqëria civile, palët e tjera të interesuara dhe përdoruesit e mjedisit, natyrës, biodiversitetit, peizazhit dhe të burimeve natyrore. Ende ka raste të konfliktit të interesi ndërmjet përdoruesve të burimeve natyrore, por edhe në drejtim të njohjes apo mbivendosjes së kompetencave nga administrata publike, bashkitë dhe organet e tjera ligjzbatuese në nivel qendror dhe lokal. Pra mungon bashkëpunimi i pushtetit qendror dhe atij lokal për problematikën mjedisore.

Ndër problemet kryesore që kanë shkaktuar një zhvillim jo të qëndrueshëm dhe në disa raste kaotik mund të përmendim: strukturat e dobëta administrative; mungesa e politikave integruese; mungesa e burimeve financiare; zhvillimet e ndjeshme sociale e ekonomike gjatë periudhës së tranzicionit; lëvizja demografike; zënia e pakontrolluar e territorit; urbanizim pjesërisht i planifikuar dhe në disa zona kaotik e informal, etj.

Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile (OMShC) janë struktura të rëndësishme për të ndërmjetësuar pjesëmarrjen e suksesshme të publikut në procesin e vendimmarrjes, duke siguruar që mendimet dhe pikëpamjet e tyre të merren në konsideratë. Këto organizata, krahas vijimit të procesit të ngritjes së kapaciteteve të tyre, të promovimit të natyrës, të forcimit të rolit dhe të rritjes së bashkëveprimit konkret me komunitetet, palët e tjera të interesuar si dhe me strukturat shtetërore në nivel kombëtar e qendror dhe ato private që kanë interesa për ruajtjen e natyrës dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, duhet të ndërmarrin iniciativa dhe të përfshihen më mirë edhe në monitorimin dhe advokimin (investigimin) e problematikave të ruajtjes së natyrës dhe të biodiversitetit në nivel lokal dhe qendror, duke rritur presionin dhe pjesëmarrjen e tyre në qeverisjen e qëndrueshme të burimeve natyrore, nëpërmjet pjesëmarrjes, sensibilizimit dhe trajnimit e anëtarëve të këshillave bashkiake si dhe në Komisionet përkatëse të Kuvendit të Shqipërisë.

5.ANALIZA E TË DHËNAVE TË PYETËSORIT DHE PËRGATITJA E RAPORTIT

Përshkruani gjithë procesin e grumbullimit dhe të analizimit të të dhënave të pyetësorit sipas metodikës, të analizave të tjera për problemet kryesore mjedisore dhe përgatitjes së raportit.

Plotësimi dhe interpretimi i të dhënave të pyetësorit/anketimit duhet të bazohet tek metodologjia e hartuar për këtë qëllim. Synimi kryesor është identifikimi dhe vlerësimi që lidhet me njohjen e problematikave aktuale që shqetësojnë dhe shoqërojnë ruajtjen, administrimin dhe menaxhimin e mjedisit, të burimeve të tyre natyrore dhe zonat e mbrojtura, në nivel Nj.Ad dhe bashkie.

Raporti hartohet nga eksperti dhe drejtuesi i organizatës partnere, mbi bazën e rezultateve dhe të të dhënave të anketimit të siguruar për secilën Nj.Ad., përfshi edhe nga burimet e tjera, nga takimet si analiza e të gjitha akteve ligjore në fuqi, në lidhje me administrimin dhe qeverisjen e burimeve natyrore; kuadri ligjor që rregullon fushën e veprimit të institucioneve përgjegjëse në nivel lokal; aktet administrative që përcaktojnë rregulla të përgjithshme, norma e standarde të detyrueshme në kushtet e qeverisjes vendore.

Gjithashtu, eksperti duhet të mbledhi dhe analizoj dokumentat, programe, planet zhvillimore, të menaxhimit dhe të veprimit në mjedis, projektet për burimet natyrore dhe zonat e mbrojtura, raportet, analizat dhe çdo informacion përkatëse në lidhje me problematika mjedisore dhe të burimeve natyrore në nivel vendor, të cilat duhet ti pasqyrojë tek raportit në nivel bashkie.

Gjatë hartimit të raportit duhet bërë një përshkrim i problemeve kryesore mjedisore dhe të burimeve natyrore si dhe një listë e tyre, që do të shërbej në zgjidhjen e problemeve nga autoritetet vendore, për disa raste duhet të rishikojnë praktikën që janë përdorur për menaxhim të çështjeve mjedisore dhe të rekomandimeve që në të ardhmen duhet të merren parasysh për ta përmirësuar situatën në të cilën ndodhet mjedisi.

Njëherazi parashtrohet një analizim i hollësishëm të situatës mjedisore për çështjet e marra në konsideratë, duke paraqitur të gjitha aspektet në këto drejtime:

Shfrytëzimi i tokës

- Humbja e tokës me cilësi të lartë bujqësore në zonën fushore e kodrinore;
- Zgjerimi i vendbanimeve dhe zonave tregtare e industriale;
- Toka të degraduara që e zvogëlojnë vlerën e peizazhit rural;
- Parcela të fragmentuara të tokave bujqësore;
- Coptimi dhe ndërrimi i destinacionit të tokave bujqësore.

Burimet ujore dhe menaxhimi i tyre

- Shfrytëzimi i pakontrolluar i burimeve ujore;
- Menaxhim jo i duhur i ujërave të zeza;
- Mungesa e trajtimit të ujërave urbane e rurale;
- Degradimi i shtretërve të lumenjëve dhe vijës bregdetare;

- Cilësi dhe sasi e pamjaftueshme e ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor;
- Qasja në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit është ende e kufizuar për shumë fshatra;
- Mbrojtja jo efikase e burimeve ujore.

Menaxhimi i mbeturinave

- Menaxhim jo efikas i mbeturinave dhe roli i njësive administrative;
- Përfshirje jo e plotë e ekonomive familjare dhe e bizneseve në sistemin e grumbullimit të mbeturinave;
- Numri i madh i deponive ilegale;
- Nivel i ulët i ndarjes dhe reciklimit të mbeturinave.

Natyra dhe biodiversiteti

- Mbrojtje jo e mjaftueshme e biodiversitetit dhe e peizazhit natyror;
- Rritja e funksionalitetit, të përgjegjësisë të organeve menaxhuese, monitoruese dhe ligjzbatuese për zonat e mbrojtura, në nivel qendror e lokal;
- Mungesa e Planit lokal për mbrojtjen e biodiversitetit dhe zbatim jo i plotë i planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura;
- Degradimi i pyjeve, prerjet ilegale në rritje dhe zjarret;
- Mi shfrytëzimi i llojeve të florës dhe faunës së egër përfshi peshkimin dhe kullotjen;
- Ndryshimi fizik i habitateve (shndërrimi, thjeshtimi dhe coptimi i tyre);
- Mungesa e planeve lokale për zhvillimin e turizmit dhe promovimit të ekoturizmit.

Proces i rëndësishëm mbetet hartimi i listës së prioritetëve të cilat do të jenë baza e punës dhe e veprimeve advokuese e lobuese, pranë organeve përgjegjëse në nivel qendror e vendor, nga OShC-t dhe OJF-t e rrjetëzuara.

Raporti i identifikimit dhe vlerësimit duhet të parashtroi një model zhvillimi afatgjatë, duke paraqitur rastet pozitive të menaxhimit apo efekteve të reformave gjatë këtyre viteve, rekomandimet profesionale, të paanshme, të ekuilibruara, gjithëpërfshirëse, mbi mundësitë e përdorimit të qëndrueshëm dhe rikuperimit të burimeve dhe zbatimit të parimeve të menaxhimit të mjedisit, bazuar në menaxhimin e integruar dhe të qëndrueshëm dhe një plan veprimi lidhur me arritjen e targeteve të planifikuara.

Raporti dhe rezultatet e pyetësorit do t'i paraqiten bashkive përkatëse, duke kërkuar adresimin e problematikave, por edhe ofruar ndihmën dhe ekspertizën e organizatave të grupimit në ndërgjegjësimin e publikut dhe aktorëve të tjerë si dhe në zgjidhjen e problemeve lokale.

6. REKOMANDIME

Përcakto gjetjet dhe rekomandimet, sipas rezultateve të të dhënave nga pyetësori, dokumentave të tjera dhe raportit përfundimtar.

ANEKSET

1. Tabela: Lista përmbledhëse e problematikave mjedisore dhe të burimeve natyrore, në bashkie

2. Pyetësorit dhe Grafikët e plotësuar, në nivel bashkie.

TË DHËNAT E PYETËSORIT

Emri i Organizatë partnere: “ _____ ”

Emri i OJF-s së rrjetit që përfshihet në procesin e anketimit: “ _____ ”

a. Bashkia _____

b. Njësia Administrative _____

Data e kryerjes së anketimit: . . .2022

PËRGJIGJA E PYETJEVE:

1. Grupmoshat e përfshira në anketim.

– Vendos shenjën X, në kutinë përkatëse.

Grupmoshat	Të Rinj	Femra	Meshkuj	Administrata publike	Anëtar të OJF	Profesioni	Arsimi	
							I Lartë	I Mesëm
15 -25								
26- 40								
41 - 55								
56 - 65								
Mbi 66								
Totali						X	X	X

2.Sa e rëndësishme është ruajtja e mjedisit natyror në bashkinë tuaj?

– Vendos shenjën X, në kutinë përkatëse.

a. Shumë e rëndësishme	
b. Disi e rëndësishme	
c. Nuk është e rëndësishme	
d. Refuzon	

3.A ka plan veprimi për mjedisin të miratuar në bashkinë tuaj?

– Vendos shenjën X, në kutinë përkatëse.

a. PO	
b. JO	
c. Nuk e di	

Nëse PO, si është zbatuar?

– Vendos shenjën X, në kutinë përkatëse.

a. Shumë mirë	
b. Mirë	
c. Mjaftueshëm	
d. Nuk është zbatuar	

4.A mendoni se problemet mjedisore janë prioritare në politikën vendore?

– Vendos shenjën **X**, në kutinë përkatëse.

a. PO	
b. JO	
c. Nuk e di	

5.A organizohen takime të rregullta nga administrata e bashkisë për e ruajtjen dhe administrimin e burimeve natyrore?

– Vendos shenjën **X**, në kutinë përkatëse.

a. PO	
b. Një herë në vit	
c. Dy herë në vit	
d. Takime të shpeshta	
e. Asnjehere	

6.Cili është mendimi juaj për punën e strukturave të bashkisë në lidhje me ruajtjen dhe përdorimin e burimeve natyrore?

– Vendos shenjën **X**, në kutinë përkatëse.

a. Shumë mirë	
b. Mirë	
c. Mjaftueshëm	
d. Dobët	
e. Nuk e di	

7.Si e vlerësoni nivelin e përfshirjes Suaj në punët dhe problemet mjedisore të bashkisë?

– Vendos shenjën **X**, në kutinë përkatëse.

a. I përfshirë plotësisht	
b. Mjaftueshëm	
c. Në nivel të ulët	
d. Nuk jam përfshirë	

8.A jeni përfshirë në ndonjë aktivitet në problematika mjedisore?

– Vendos shenjën **X**, në kutinë përkatëse.

a. PO	
b. JO	

Nëse PO, listoni aktivitetet ku jeni përfshirë:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

9. Si OJF, a Ju kërkojnë mendimin tuaj mbi çështjet në lidhje me aktivitetet mjedisore që zhvillon bashkia?

Plotësohet vetëm nga OJF-t e rrjetit. – Vendos shenjën **X**, në kutinë përkatëse.

a. PO	
b. JO	

Nëse PO, listoni aktivitetet ku jeni përfshirë:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

10. Cili është mendimi juaj për zbatimin e ligjshmërisë në lidhje me ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore?

– Vendos shenjën **X**, në kutinë përkatëse.

a. Shumë i mirë	
b. I Mirë	
c. Mjaftueshëm	
d. I Dobët	
e. Nuk e di	

11. A ka raste të dukurive të korrupsionit dhe krimit mjedisor në administrimin dhe përdorimin e burimeve natyrore në bashkinë tuaj?

– Vendos shenjën **X**, në kutinë përkatëse.

a. PO	
b. JO	

Nëse PO, përshkruani në vecanti shtrirjen e tyre dhe cilët janë përgjegjës nga institucionet në nivel lokal? - Listo

12. Përshkruani nismat e Oganizatës dhe të rrjetit tuaj për parandalimin, luftimin dhe adresimin e rasteve të korrupsionit në përdorimin e burimeve natyrore.

– Plotësohet vetëm nga OJF-t e rrjetit

13. Nga pikëpamja Juaj, cilat janë vlerat më të rëndësishme mjedisore e natyrore në bashkinë tuaj?

Listoni vlerat sipas rëndësisë:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
- etj. _____

14. Cilat janë përfitimet më të rëndësishme social-ekonomike dhe ekoturistike që territori i bashkisë ofron për komunitetin lokal.

Listoni përfitimet më të rëndësishme për komunitetin:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
- etj. _____

15. Identifikoni se cilët janë problemet me ndikim negativ, që dëmtojnë mjedisin, natyrën, biodiversitetin dhe peizazhin në bashkinë tuaj?

Listoni problemet me ndikim negativ:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
- etj. _____

16. Nga problematikat e identifikuar me ndikim negativ, shënoni veprimtaritë, sipas riskut potencial (nivelit të dëmtimit) të tyre.

Listo veprimtaritë dhe vendos **shenjën X** te risku.

Nr.	Veprimtaritë	Tjetërsues	Shumë i rëndë	I rëndë	Mesatar	I dobët
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						
6.						
7.						
8.						
9.						
10.						

17. Cilët janë shkaqet kryesore të ndikimeve negative të mjedisit në bashkinë tuaj?

Listoni shkaqet kryesore:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
- etj. _____

18. Cilët janë shkaktarët e dëmtimit dhe ndotjes së mjedisit në bashkinë tuaj?

Listoni shkaktarët:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
- etj. _____

19. Përcaktoni 2 prioritete më të domosdoshme të problematikave në mjedis dhe burimet natyrore të cilat duhen bërë prezent në strukturat e bashkisë apo/dhe në autoritetet e tjera shtetërore në nivel lokal.

1. _____
2. _____

20. A ka zona të mbrojtura, që përfshihen në territorin e bashkisë?

– Vendos shenjën X, në kutinë përkatëse.

a. PO	
b. JO	

Nëse PO, kush janë dhe listoni problematikat me cilat ndeshen:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____
10. _____

21.A zhvillohen aktivitete ndërgjegjësuere dhe edukuese në zonën tuaj për promovimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore?

– Vendos shenjën **X**, në kutinë përkatëse.

a. PO	
b. JO	
c. Nuk e di	

Nëse PO, listoni se cilat janë ato?

1. _____
 2. _____
 3. _____
 4. _____
 5. _____
- etj.** _____

22.A janë trajtuar në mediet lokale problematikat e menaxhimit të mjedisit dhe të burimeve natyrore?

– Vendos shenjën **X**, në kutinë përkatëse.

a. PO	
b. JO	
c. Nuk e di	

Nëse PO, listoni se cilat janë ato:

1. _____
 2. _____
 3. _____
 4. _____
 5. _____
- etj.** _____